

VENDIM

Nr. 56, dt. 11.03.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.03.2016, pasi shqyrtoi detajet e kangjellave të strehëve dhe të ndriçuesve të diskutuara më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohen detajet e propozuara të kangjellave metalike të mbulesave (tenda) dhe të ndriçuesve për objektet 1,2,3,4,8,9,11,13,14,16,17,18,19,27,28 dhe H1 dhe H5, Pazari i Korçës.
Miratohet variant 1 i propozuar për kangjellat e mbulesave dhe të ndriçuesve.
2. Të hiqet tabela e reklamës së Qendrës Tregtare “Pazari Korçë” nga fasada e objektit.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI



KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

